



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:123679

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004609

C.nr.868/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.C.nga M., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ibadete Xhafa Kuçi, avokate nga Suhareka, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arbnor Murturi, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i shujtës ushqimore dhe shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës, më datë 25.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K.C.nga M., dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, që paditësen për periudhën kohore nga data 11.03.2020 deri më datë 21.11.2022, respektivisht për 470 ditë pune ta kompensojë si në vijim:
 - i.** në emër të shujtës ushqimore, t'ia paguajë shumën prej 2.00€ (dy euro) për një ditë pune, apo shumën e përgjithshme prej 940.00€ (nëntëqind e dyzet euro);
 - ii.** në emër të shpenzimeve të udhëtimit, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë të prej 658.00€ (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë euro), apo shumën e përgjithshme prej 1,598.00€ (njëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë euro).
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, që paditëses shumën si në pikën I i të dispozitivit t'ia paguajë me kamatë në lartësi prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e

paraqitjes së padisë, më datë 17.06.2021, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 125.00€ (njëqind e njëzet e pesë euro), të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja K.C.nga M., përmes përfaqësueses së saj të autorizuar, më datë 17.06.2021, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, për kompensimin e shujtës ushqimore dhe shpenzimeve të udhëtimit, të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 21.06.2023. Në padi, paditësja ka theksuar se e njëjta është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “T”, në komuna e M. Tutje ka shtuar se pavarësisht kërkesës së saj, e paditura nuk e ka kompensuar për shpenzimet në emër të shujtës ushqimore dhe shpenzimeve të udhëtimit, andaj duke u mbështetur në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyrojë të paditurën Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë që paditëses për periudhën kohore nga data 11.03.2020 deri më datë 31.05.2021, në emër të shujtës ushqimore për 152 ditë pune t’ia paguajë shumën 304.00€, ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 152 ditë pune, duke e llogaritur 70% të biletës së udhëtimit, që i bie të jetë 1.40€, t’ia paguajë shumën prej 212.80€, apo shumën e përgjithshme prej 516.80€ ndërsa me parashtrësën për zgjerim të padisë ka kërkuar kompensimin si në vijim: për periudhën kohore nga data 01.06.2021 deri më datë 31.12.2021 dhe për periudhën kohore nga data 04.01.2022 deri më datë 21.11.2022, në emër të shujtës ushqimore për 318 ditë pune t’ia paguajë shumën prej 636.00€ ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 318 ditë pune, duke e llogaritur 70% të biletës së udhëtimit, t’ia paguajë shumën prej 445.20€, apo shumën e përgjithshme prej 1,081.20€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke i specifikuar dhe atë: 104.00€ për përpilimin e padisë, dhe 21.00€ për taksë gjyqësore dhe provizion bankar.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket shujtës ushqimore ndërsa e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit

të shpenzimeve të udhëtimit, me arsyetimin se paditësja pretendimin e saj nuk e ka bazuar në asnjë provë me të cilën vërtetohet se ka krijuar shpenzime të udhëtimit për shkak të marrëdhënies së punës ashtu siç e parasheh dispozita e nenit 322 par.2 të LPK-së, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës ka propozuar që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale pasi paditësja vetëm pjesërisht ka pasur sukses në procesin gjyqësor.

Pas vlerësimit të pretendimeve të palëve dhe provave të bashkangjitura nga ana e tyre, gjykata konstatoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës së nenit 398 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “T”, në S, komuna e M. Kjo u provua edhe përmes vërtetimit me numër protokolli 43/2023 të datës 08.02.2023, të lëshuar nga institucioni arsimor i lartëcekur, i cili poashtu dëshmon se paditësja në vitin 2020 ka 30 ditë pune, në vitin 2021 ka 182 ditë pune ndërsa në vitin 2022 ka 136 ditë pune pranë këtij institucioni arsimor. Ky vërtetim është në përputhje edhe me vërtetimin me nr.protokolli 04/2023 të datës 10.01.2023, të lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme të Ulët “T”, në S. me të cilin provohet se paditësja për periudhën kohore 18.01.2021 – 30.12.2021, pranë këtij institucioni ka 182 ditë pune, si dhe atë me nr.protokolli 85/2021 të datës 31.05.2021, të lëshuar po nga ky institucion arsimor, me të cilin provohet se paditësja për periudhën kohore nga data 11.03.2020 deri më datë 31.05.2021, pranë këtij institucioni ka 152 ditë pune.

Nga kërkesa me nr.07/120/08-0042568/21 e datës 03.06.2021, rezulton se paditësja i është drejtuar me kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të shujtës ushqimore dhe shpenzimeve të udhëtimit këtu të paditurës.

Nga vërtetimi i datës 08.02.2023 i lëshuar nga N.T.P “B. T.”, në M., rezulton se paditësja është udhëtare e kësaj kompanie dhe se çmimi i biletës njëdrejtimëshe në relacionin M.– fshati S. është 1.00€ respektivisht 2.00€, në dy relacionet.

Nga çertifikata e vendbanimit e lëshuar nga MPB, Republika e Kosovës rezulton se vendbanimi i paditëses është në Mitrovicë, Rr."A.P. T.", nr.14.

Nga kopja e letërnjoftimit të paditëses, të lëshuar nga MPB, Republika e Kosovës, rezulton se paditësja vendbanimin e ka në Mitrovicë.

Provave materiale të lartcekura, gjykata u'a fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës së nenit 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të."*, si dhe në kuptim të par.2 të po kësaj dispozite ligjore, e cila përcakton se: *"Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike."*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), me datë 22.01.2021.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, parashihet me dispozitën e nenit 35 par.7 të Kontratës së lartcekur, ku është përcaktuar se: *"Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim"*, ndërsa çështja e shpenzimeve të udhëtimit është e rregulluar me par.5 të kësaj dispozite ligjore përcaktohet se: *"Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban"*.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilës është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paditësja është e legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqësve, në kuptim të dispozitës nga neni 245 i Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Sa i përket kërkesës për kompensimin e shpenzimeve në emër të shujtës ushqimore, gjykata gjen se paditësja me provat e bashkangjitura padisë, ka dëshmuar se i takon një kompensim i tillë e poashtu edhe e paditura me anë të përgjigjes në padi e ka pohuar një kërkesë të tillë, andaj edhe gjykata gjeti se kjo kërkesë e paditëses është e bazuar, për çka edhe të njëjtën e aprovoi duke vendosur si në pikën I i) të dispozitivit.

Sa i përket kërkesës së paditëses për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, nga provat e administruara gjykata vërtetoi se paditësja e ka vendbanimin në M., ndërsa vend punimin e ka në fshatin S. dhe për faktin se vend punimi i paditëses ka qenë jashtë vendbanimit të saj, rezulton se e njëjta për çdo ditë të pranisë në punë ka udhëtuar brenda vendbanimit të Komunës përkatëse ku ka punuar, në relacionet M.-S. dhe anasjelltas duke paguar biletë kthyesë në lartësi prej 2.00€, andaj edhe i'a njohu kompensimin duke vendosur si në pikën I ii) të dispozitivit, duke bërë llogaritjen në atë mënyrë që ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me 70% të çmimit të biletës së trafikut urban në relacionet ku e njëjta ka udhëtuar, sipas përlllogaritjes $1.40€ \times 470 = 658.00€$ duke i'a njohur kompensimin në lartësi prej 658.00€, duke pasur parasysh faktin se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Në këtë pjesë gjykata mori parasysh edhe pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se paditësja nuk ka arritur që të provojë shpenzimet e krijuara të udhëtimit, por të njëjtat i gjeti si të pabazuara pasi që nga vërtetimet e lëshuara nga e paditura dhe kompania e udhëtimit vërtetohen ditët e punës së paditëses, periudha kohore gjatë së cilës e njëjta ka udhëtuar në relacionin Mitrovicë-fshati Stantërg, poashtu nga çertifikata e

vendbanimit e bashkangjitur si provë, gjykata vërtetoi vendbanimin e paditëses i cili rezulton të jetë në Mitrovicë ndërsa vendpunimi i saj në fshatin Stantërg. Poashtu nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja ka bërë kërkesë pranë të paditurës për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, mirëpo e paditura nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të paditëses.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me përfshirjen në parashkrim të kërkesës së paditëses sa i përket shpenzimeve të udhëtimit edhe pse ky pretendim nuk është elaoburuar në përgjigje në padi por vetëm është përmendur dhe gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar pasi që paditësja ka kërkuar kompensim fillimisht për periudhën kohore nga data 11.03.2020 – 31.05.2021 ndërsa padinë në gjykatë e ka parashtruar më datë 17.06.2021, ndërsa me parashtrësën për zgjerim të padisë të datës 21.06.2023, ka kërkuar kompensim edhe për periudhën kohore nga data 01.06.2021 deri më datë 31.12.2021 dhe për periudhën kohore nga data 04.01.2022 deri më datë 21.11.2022, që nënkupton se të gjitha kërkesat e parashtruara janë brenda afatit 3 (tre) vjeçar dhe nuk ka parashkrim të kërkesave.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të dispozitës së nenit 382 të LMD-së, sipas së cilës përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë, më datë 17.06.2021.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 449 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për padi në shumë prej 104.00€, dhe për taksë gjyqësore dhe provizion bankar në shumë prej 21.00€.

Nga sa u tha më lart e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.868/2021 më datë 25.07.2024

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.